



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit

SP-098

Prishtinë, më 19 prill dhe 4 maj 2017

**P R O C E S V E R B A L**

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,  
E MBAJTUR MË 19 PRILL DHE 4 MAJ 2017**

Seancën e drejtuan nënkryetarët e Kuvendit, Xhavit Haliti dhe Sabri Hamiti.

Nënkryetari i Kuvendit, Xhavit Haliti, i hapi punimet e seancës plenare sipas rendit të ditës të përgatitur nga Kryesia e Kuvendit në mbledhjen e mbajtur më 14 prill 2017.

Ai procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

**1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës**

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën këta deputetë: Bekim Haxhiu, Sadri Ferati, Albin Kurti, Teuta Haxhiu, Valdete Bajrami, Margarita Kadriu, Selvije Halimi, Blerim Grainca, Glauk Konjufca, Shukrije Bytyçi, Labinotë Demi-Murtezi, Vjosa Osmani dhe Fatmir Shurdhaj, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

**2. Koha për pyetje parlamentare**

Deputetja Mexhide Mjaku-Topalli i parashtrroi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me ndërtimin e një rrethrotullimi në hyrje të qytetit të Ferizajt. Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Faton Topalli i parashtoi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, në lidhje me largimin e deponisë së mbeturinave në afërsi të fshatrave Gurrëz dhe Komogllavë të komunës së Ferizajt.

Ministri Ferat Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Mytaher Haskuka i parashtoi pyetje ministrit të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, Ferat Shala, në lidhje me masat që ka ndërmarrë ministria dhe Qeveria për mbrojtjen e qytetarëve nga fatkeqësitë natyrore sipas dispozitave ligjore.

Ministri Ferat Shala iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Shqipe Pantina i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me mungesën e transportit publik në AN “Adem Jashari” të Prishtinës.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Faton Topalli i parashtoi pyetje ministrit të Infrastrukturës, Lutfi Zharku, në lidhje me ndërtimin e rrugës në fshatin Tërn, komuna e Ferizajt.

Ministri Lutfi Zharku iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputeti Abdyl Ymeri i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me vendimin e Gjykatës së Arbitrazhit për kontratën e Telekomit të Kosovës me Dardafon.net.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Shukrije Bytyçi i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me funksionalizimin e plotë të gjimnazit të specializuar matematikor në Prishtinë.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Valdete Bajrami i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me procedurën e zgjedhjes së personelit akademik në Universitetin e Prishtinës.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputetja Shukrije Bytyqi i parashtoi pyetje kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, në lidhje me ndarjen buxhetore për dezinfektimin e zonave endemike në komunën e Malishevës.

Kryeministri Isa Mustafa iu përgjigj pyetjes së deputetes.

Deputeti Lahi Brahimaj i parashtoi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me mungesën e inventarit dhe energjisë elektrike në disa shkolla të komunës së Gjakovës dhe asaj të Klinës.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetit.

Deputetja Teuta Haxhiu i parashtroi pyetje ministrit të Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arsim Bajrami, në lidhje me zbatimin e Kontratës Kolektive.

Ministri Arsim Bajrami iu përgjigj pyetjes së deputetes.

**3. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit**

Për mungesë të propozueses, deputetes Donika Kadaj-Bujupi, për ta paraqitur dhe arsyetuar mocionin për interpelancë, kjo pikë u shty për seancën tjetër.

**4. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike**

Për mungesë të ministrit Blerand Stavileci, ndaj të cilit ishte parashtruar mocioni për interpelancë, kjo pikë u shty për një seancë tjetër.

**5. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetes Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputetë të tjerë nënshkrues, në lidhje me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Teuta Haxhiu, e mbështetur edhe nga 9 deputetë të tjerë nënshkrues, ka kërkuar debat parlamentar lidhur me zbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga ana e Qeverisë së Republikës së Kosovës si dhe ka propozuar për miratim disa rekomandime, të cilat u janë shpërndarë deputetëve.

Kryesuesi e ftoi deputeten Teuta Haxhiu që ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin për debat parlamentar.

Deputetja Teuta Haxhiu, duke e arsyetuar kërkesën për debat parlamentar, ndër të tjera tha se Qeveria e Kosovës është institucioni që më së paku i ka përfillur rekomandimet e Avokatit të Popullit. Në vitin 2015, nga 60 rekomandime, 36 prej tyre fare nuk i ka zbatuar, 7 rekomandime prej 2 vjetësh janë në pritje të zbatimit.

Përpos Qeverisë së Kosovës, janë edhe institucionet e tjera qeveritare, të cilat nuk i përfillin rekomandimet e Avokatit të Popullit, e këtu hyjnë Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale, gjykatat, Shërbimi Korrektues etj.

Në fund të diskutimit të saj, deputetja Teuta Haxhiu i paraqiti 5 rekomandime që kanë të bëjnë me zbatimin konkret të rekomandimeve të Avokatit të Popullit.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për çështjen e shtruar.

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Mexhide Mjaku-Topalli, në emër të GP të PDK-së, Lirie Kajtazi, në emër të GP të LDK-së, Mytaher Haskuka, në emër të GP të LVV-së, Ali Berisha, në emër të GP të AAK-së, Shukrije Bytyqi, në emër të GP “Nisma”, pastaj kryeministri Isa Mustafa si dhe deputetët Bali Muharremaj, Vjosa Osmani, Albulena Haxhiu, Selvije Halimi, Ismail Kurteshi, Blerta Deliu-Kodra, Mytaher Haskuka, Daut Haradinaj, Zafir Berisha, Fatmir Shurdhaj, Faton Topalli dhe Teuta Haxhiu, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Në fund të debatit, deputetja Teuta Haxhiu kërkoi rekomandimet e propozuara të harmonizohen edhe me grupet e tjera parlamentare dhe në seancën tjetër të miratohen.

## **6. Debat parlamentar sipas kërkesës së deputetëve Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaçu, mbështetur edhe nga 8 deputetë të tjerë nënshkrues, në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Bekim Haxhiu dhe Xhevahire Izmaçu, të mbështetur edhe nga 8 deputetë të tjerë nënshkrues, kanë kërkuar debat parlamentar lidhur me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë si dhe i kanë propozuar për miratim disa rekomandime, të cilat u janë shpërndarë deputetëve.

Kryesuesi e ftoi deputetin Bekim Haxhiu që ta paraqesë dhe ta arsyetojë propozimin për debat parlamentar.

Deputeti Bekim Haxhiu, duke e arsyetuar kërkesën për debat parlamentar, ndër të tjera tha se vetëm gjatë 5 vjetëve të fundit në sektorin e ndërtimtarisë 61 qytetarë e kanë humbur jetën në vendet e tyre të punës, ndërsa 220 të tjerë janë lënduar. Ky numër mund të jetë shumë më i madh, sepse shumë raste të lëndimeve dhe vdekjeve nuk raportohen fare.

Shkeljet e të drejtave të punëtorëve janë të ndryshme dhe të shumta, duke filluar nga mungesa e kontratave, tejkalimit të orarit ligjor të punës, mohimi i pushimit javor dhe vjetor e shumë e shumë shkelje të tjera.

Shembull më i rëndë i shkeljeve të të drejtave të punëtorëve është largimi kolektiv i punëtorëve nga kompania e KEDS-it.

Megjithëse Inspektorati i Punës ka vendosur në favor të punëtorëve të larguar nga puna në të dy shkallët e vendosjes së tij, KEDS-i nuk i ka përfillur vendimet e Inspektoratit.

Situatë e njëjtë është edhe me punëtorët e sektorit të ndërtimtarisë, të cilëve u shkelën të drejtat elementare në vendet e tyre të punës, si në sektorin publik, ashtu dhe në atë privat.

Pastaj, kryesuesi hapi debatin për çështjen.

Lidhur me këtë pikë diskutuan: Armend Zemaj, në emër të GP të LDK-së, Faton Topalli, në emër të GP të LVV-së; Pal Lekaj, në emër të GP të AAK-së; ministri Arban Abrashi, si dhe deputetët Abdyl Ymeri, Mexhide Mjaku-Topalli, Besa Baftiu, Agim Aliu, Puhie Demaku, Shaip Muja, Ismail Kurteshi, Luljeta Gutaj-Veselaj, Lirie Kajtazi, Blerta Deliu-Kodra, Shqipe Pantina, Nuredin Ibishi, Mytaher Haskuka, Hajdar Beqa, Albin Kurti, Labinotë Demi-Murtezi dhe Selvije Halimi, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Deputeti Bekim Haxhiu propozoi që këto rekomandime, bashkë me konkluzionet që janë nxjerrë nga monitorimi i Ligjit të Punës, të harmonizohen në Komisionin Parlamentar, e pastaj të procedohen për miratim në Kuvend.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës në orën 17:50 minuta.

\* \* \*

*E enjte, më 4 maj 2017*

*Vazhdimi i mbledhjes plenare, e filluar më 19 prill*

Nënkryetari procedoi me pikat e rendit të ditës, si në vijim:

### **1. Votimi i Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet**

Kryesuesi theksoi se ky projektligj është proceduar në disa seanca, por në mungesë të kuorumit të mjaftueshëm për vendimmarrje nuk ka kaluar.

Ai e hodhi në votim Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

|                 |     |
|-----------------|-----|
| Për -----       | 32, |
| Kundër -----    | 25  |
| Abstenime ----- | 12. |

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për minierat dhe mineralet.

### **2. Votimi i Propozim-rezolutës në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se votimi i kësaj pike është përsëritura në disa seanca, por nuk ka pasur kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Pastaj kryesuesi e hodhi në votim Propozim-rezolutën në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 22,  
Kundër ----- 31,  
Abstenime -----16.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Propozim-rezolutën në lidhje me arrestimet e aktivistëve të Lëvizjes “Vetëvendosje”.

### **3. Votimi i rekomandimeve në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar.

Ai i hodhi në votim rekomandimet në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,  
Kundër ----- 5,  
Abstenime -----3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i miratoi rekomandimet në lidhje me moszbatimin e rekomandimeve të Avokatit të Popullit nga Qeveria e Republikës së Kosovës, si në vijim:

1. Të implementohen rekomandimet e Avokatit të Popullit të vitit 2015;
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të krijojë kushte të nevojshme në kuptimin financiar që rekomandimet e Avokatit të Popullit të implementohen;
3. Komisionet parlamentare obligohen të përfshijnë çështjet që dalin nga raportet vjetore të Avokatit të Popullit në planet e tyre të punës;
4. Kryeministri i Republikës së Kosovës, si kryesues i Grupit ndërmnistror për të drejtat e njeriut, të raportojë në Kuvend të paktën një herë në vit;
5. Komisionet parlamentare t’i ftojnë në debat udhëheqësit e institucioneve në komisionet përkatëse në Kuvend, për t’i kuptuar arsyet e moszbatimit të rekomandimeve të Avokatit të Popullit;

6. Kuvendi i Kosovës, gjatë plotësim-ndryshimit të Rregullores së Kuvendit, të parashohë vetëm diskutimin e raportit vjetor të Avokatit të Popullit, e të mos hidhet në votim;

7. Të zbatohet rezoluta e Kuvendit të Republikës së Kosovës lidhur me kontributet pensionale të qytetarëve të Kosovës, të mbajtura ilegalisht nga Serbia.

#### **4. Votimi i rekomandimeve në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se diskutimet për këtë pikë kanë përfunduar në seancën e kaluar.

Ai i hodhi në votim propozim-rekomandimet në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,  
Kundër ----- 0,  
Abstenime -----2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi i miratoi rekomandimet në lidhje me shkeljen e të drejtave të punëtorëve në Kosovë:

1. Obligohet Inspektorati i Punës që të kryejë inspektime efektive në të gjithë sektorët, të bëjë monitorimin e respektimit të të drejtave të punëtorëve në të gjitha ndërmarrjet publike dhe private dhe të gjitha raportet e inspektimeve dhe masat e shqiptuara t'i publikojë në ueb-faqen e Inspektoratit të Punës;
2. Deputetët e Kuvendit të Kosovës janë kundër çdo largimi kolektiv nga puna. Prandaj, kërkohet nga KEDS-i që të kthejë në vendet e punës 95 punëtorët e larguar në mënyrë kolektive;
3. Të respektohet Kontrata Kolektive, në të gjithë sektorët dhe në të gjitha ndërmarrjet;
4. Të respektohet Ligji i Punës dhe Ligji për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë dhe ligjet e tjera që rregullojnë të drejtat e punëtorëve, marrëdhëniet në mes të punëtorëve dhe punëdhënësve;
5. Të funksionalizohen: Këshilli Ekonomik Social i Kosovës dhe Këshilli Kombëtar për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë, duke u plotësuar me ekspertë të fushave përkatëse sipas ligjeve në fuqi;
6. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale të aprovojë strategjinë për mbrojtjen e punëtorëve, për sigurinë dhe shëndetin në punë;

7. Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale obligohet të rrisë kapacitetet e Inspektoratit të Punës, transparencën dhe llogaridhënien dhe
8. Inspektorati i Punës obligohet që çdo tre muaj të raportojë në Komisionin Parlamentar për gjetjet nga inspektimet, për nivelin e shkeljeve të të drejtave të punëtorëve në Kosovë.

**5. Interpelanca e kryeministrit të Kosovës, Isa Mustafa, sipas kërkesës së deputetes Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se deputetja Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, ka parashtruar kërkesë për ta ftuar në interpelancë kryeministrin e Kosovës, z. Isa Mustafa, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit.

Ai i njoftoi deputetët për kohëzgjatjen e interpelancës prej tri orësh, si dhe për kohën e ndarë për secilin grup parlamentar dhe për deputetët pa grup parlamentar.

Kryesuesi e ftoi propozuesen e interpelancës që ta marrë fjalën.

Deputetja Donika Kadaj-Bujupi tha se Kosova po përballet me krizën e thellë energjetike. Problem është situata e rëndë në fushën e mihjes së Sibocit për shkak të 260 ndërtimeve pa leje.

Për shkak të ndërprerjes së punimeve në mihjen e Sibocit, Korporata Energjetike e Kosovës, përpos importimit të energjisë elektrike, është e detyruar të importojë edhe thëngjill. KEK-u për momentin është duke i shfrytëzuar disa mbetje të pashfrytëzuara për furnizimin e termocentraleve me thëngjill, e ky shfrytëzim po shkakton plasaritje në shtëpitë aktuale, të cilat po rrezikojnë jetët e njerëzve.

Ky rrezik do të mund të shmangej sikur të ishin respektuar dispozitat ligjore në fuqi, si: vendimi qeveritar i vitit 2004, me të cilin mihja e Sibocit trajtohet si Zonë e interesit të veçantë ekonomik dhe Vendimi i qeverisë së vitit 2009 edhe një herë e trajton këtë pjesë si Zonë ekonomike me interes të veçantë.

Deri në vitin 2009 numri i shtëpive në këtë Zonë nuk ka qenë më shumë se 50-60, ndërsa prej këtij viti e deri sot janë ndërtuar përafërsisht 200 shtëpi pa leje ndërtimi në zonën e destinuar për mihje dhe të mbrojtur si Zonë me interes ekonomik.

KEK-u është në situatë të palakmueshme kur duhet të negociojë për kompensim me ata që kanë shkelur ligjet dhe kanë bërë ndërtime pa leje në zonën e destinuar për mihje.

Kjo çështje është në kompetencë ekskluzive të Qeverisë së Kosovës dhe Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për t'i garantuar kushte të plota për punë Korporatës Energjetike të Kosovës si dhe në marrjen e masave për çfarëdo problemi me zonat e banuara për rreth.

Në fund të fjalës së saj, deputetja Donika Kadaj-Bujupi lexoi Propozim-rezolutën prej 4 pikash, në të cilën parashihet që të përmirësohet situata në minierën e Sibocit. Diskutimi i plotë i deputetes Donika Kada-Bujupi është dhënë në transkript.

Kryesuesi e ftoi kryeministrin e Kosovës që ta paraqesë qëndrimin e Qeverisë së Kosovës në lidhje me çështjet e ngritura në këtë interpelancë.

Kryeministri i Kosovës, z. Isa Mustafa, tha se ekzistojnë arsye për të diskutuar në Kuvend çështjet e parashtruara në interpelancë, mirëpo Propozim-rezoluta është e ngarkuar me pika të panevojshme.

Ligji i përcakton qartë procedurat dhe afatet për shpronësimet, prandaj edhe nuk ka nevojë që këto çështje të rregulluara me ligj të normohen me rezolutë dhe se themelimi i korporatës publike të thëngjillit është në harmoni me vendimet e Qeverisë dhe të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik.

Dispozitat ligjore, përmes të cilave shpronësohen pronat për interes publik, janë Ligji nr. 03/L-139 për shpronësimet e pronës së paluajtshme me plotësimet e bëra me Ligjin nr. 03/L-205 si dhe me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 10/22 të datës 6 korrik 2014 dhe po ashtu edhe në bazë të dokumentit “Kornizat e politikave për zhvendosje”.

Kërkesa për iniciimin e procedurës për zhvendosje, shpronësim për pronarët e patundshmërive të fshatrave Shipitullë dhe Hade është paraqitur nga Korporata Energjetike e Kosovës në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor më 1 korrik 2014.

Më 27 gusht 2014 ministria me vendim e ka miratuar kërkesën, duke e detyruar Korporatën Energjetike të Kosovës të hartojë planin e veprimit për zhvendosje, duke u bazuar në dokumentin “Kornizat e politikave për zhvendosje” për zonën Fusha e Mihjes së Re të Republikës së Kosovës, i miratuar me vendim të Qeverisë së Kosovës.

Standardet e reflektuara në politikat e Kornizës për zhvendosje janë përgatitur nga Banka Botërore dhe janë harmonizuar me të gjitha palët e interesit në sektorin e energjisë. Në konstatimet e paraqitësit të interpelancës ka pasaktësi në krahasim me të dhënat që janë prezantuar nga Korporate Energjetike e Kosovës dhe Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Korporata Energjetike e Kosovës nuk ka importuar asnjëherë thëngjill, përkundrazi KEK-u planifikon sasi rreth 200 mijë tonë thëngjill për tregun e vendit.

Sa i përket rrezikimit të banorëve, eksploatimi i thëngjillit nga KEK-u bëhet në bazë të planit të veprimit dhe teknologjisë eksploatuese dhe se duhet të respektohet distanca e lejuar me ligj për zonat e banuara.

Në zonën e interesit përgjegjës për monitorimin dhe inspektimin e ndërtimeve është përgjegjësi i Komunës së Obiliqit, e pastaj edhe i Ministrisë së Mjedisit.

Për herë të parë në vendin tonë, por edhe në rajon janë aplikuar standarde nëpërmjet politikave të Kornizës për zhvendosje sa i përket zhvendosjes së banorëve, të cilat janë mbështetur nga palët e interesit të sektorit të energjisë, por edhe nga Banka Botërore. Procesi është përgatitur dhe monitoruar në vazhdimësi nga kompanitë ndërkombëtare.

Nga KEK-u është përgatitur Matrica e të drejtave që u është shpalosur banorëve të katër lagjeve të fshatit Shipitullë, janë dorëzuar ofertat për paketën e kompensimit për banorët e zonës me prioritet dhe është dorëzuar në ministri plani i veprimit të zhvendosjes.

Efikasiteti në implementimin e politikave të shpronësimit, zhvendosjes dhe planifikimi i ekzekutimit me kohë do të jenë kritere për mbështetjen e projektit “Kosova e Re” nga partnerët tanë ndërkombëtarë, veçmas nga Banka Botërore. Diskutimi i plotë i kryeministrit Isa Mustafa është dhënë në transkript.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin për interpelancën e parashtruar për kryeministrin Isa Mustafa.

Në lidhje me interpelancën e parashtruar për kryeministrin e Kosovës, Isa Mustafa, diskutuan: Murat Hoxha, në emër të GP të LDK-së, Visar Ymeri, në emër të GP të LVV-së, Rrustem Berisha, në emër të GP të AAK-së, Zafir Berisha, në emër të GP “Nisma”, si dhe deputetët: Shaip Muja, Ismet Beqiri, Mytaher Haskuka, Muhamet Mustafa, Melihate Termkolli, Salih Salihu, Daut Haradinaj, Adem Salihaj, Armend Zemaj, kryeministri Isa Mustafa dhe propozuesja e interpelancës, Donika Kadaj-Bujupi, diskutimet e të cilëve të plota janë dhënë në transkript.

Në fund të diskutimeve, kryesuesi e hodhi në votim Propozim-rezolutën e propozuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 19,  
Kundër ----- 37,  
Abstenime ----- 8.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi nuk e miratoi Propozim-rezolutën e propozuar nga deputetja Donika Kadaj-Bujupi, e mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, për çështjen e shfrytëzimit të thëngjillit dhe minierën e Sibocit.

## **6. Interpelanca e ministrit Blerand Stavileci, sipas kërkesës së deputetit Visar Ymeri, i mbështetur edhe nga 15 deputetë nënshkrues, në lidhje me kontratën e privatizimit të Kompanisë së Distribuimit të Energjisë Elektrike**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se në mungesë të ministrit të Zhvillimit Ekonomik, z.Blerand Stavileci, interpelanca shtyhet për ndonjë seancë tjetër.

## **7. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL e ka shqyrtuar projektligjin dhe Kuvendit i rekomandon mosmiratimin e tij.

Ai e ftoi deputeten Safete Hadërgjonaj që në emër të propozuesit ta paraqesë dhe ta arsyetojë projektligjin.

Deputetja Safete Hadërgjonaj para deputetëve të Kuvendit e paraqiti dhe e arsyetoi përmbajtjen dhe strukturën e projektligjit. Ajo i ftoi deputetët që ta miratojnë këtë projektligj.

Pastaj, kryesuesi e hapi debatin në parim për këtë projektligj.

Lidhur me Projektligjin për aftësimin, riaftësimin profesional dhe punësimin e personave nga pjesët veriore të Kosovës diskutuan: Hatim Baxhaku, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Shëndetësi dhe në emër të GP të LDK-së, Besa Baftiu, në emër të GP të LVV-së, Slavko Simiq, në emër të GP të LS-së, Shukrije Bytyçi, në emër të GP “Nisma”, Fikrim Damka, në emër të GP “6+”, si dhe deputetët Ismail Kurteshi, Mirjeta Kalludra, Zenun Pajaziti dhe Qerim Bajrami, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi konstatoi se nuk ka kuorum të mjaftueshëm për ta hedhur në votim miratimin e këtij projektligji.

## **8. Shqyrtimi i raportit të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë**

Kryesuesi i njoftoi deputetët se Komisioni FunkSIONAL për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë dhe Kuvendit i ka paraqitur raportin me rekomandime.

Ai e ftoi përfaqësuesin e Komisionit FunkSIONAL ta paraqesë dhe ta arsyetojë raportin me rekomandime.

Deputeti Salih Morina, në emër të Komisionit FunkSIONAL, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit, si dhe kërkoi nga deputetët që ta miratojnë raportin me rekomandime.

Lidhur me këtë raport diskutuan: Nait Hasani, në emër të GP të PDK-së, Ismail Kurteshi, në emër të GP të LVV-së, Teuta Haxhiu, në emër të GP të AAK-së dhe Shukrije Bytyçi, në emër të GP “Nisma”, diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Kryesuesi e hodhi në votim raportin e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 56,  
Kundër ----- 1,  
Abstenime ----- 5.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi e miratoi raportin me rekomandime të Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini e Sport lidhur me mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 03/ L-145 për fuqizim dhe pjesëmarrje të rinisë.

Kryesuesi i mbylli punimet e seancës plenare në orën 13:40 minuta.

Nënkryetari i Kuvendit:

Xhavit HALITI

*Procesverbalin e hartoi:*

*Drejtoria për Çështje Plenare dhe Procedurale*